

BULETINI I IGJK Korrik 2004

Ky Buletin është publikuar për informim sa më të plotë të gjyqësisë së Kosovës për aktivitetet e IGJK. Ky publikim i është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjithë Kosovën. Buletini mujor i IGJK tani përmbanë artikuj nga stafi i IGJK në lidhje me qështjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë.

Një seminar njëditor me diskutime të shumta – rreth Rregullores të nxjerrur para një viti mbi mbrojtjen kundër dhunës familjare

Më 5 maj Instituti Gjyqësor i Kosovës ka qenë nikoqir i një seminari rreth Mbrojtjes kundër dhunës në familje. Ishte ky seminari i dytë rreth Rregullores së re 2003/12 pasi që seminari i parë ishte mbajtur në nëntor të vitit të kaluar. Që nga atëherë janë përgjegjur shumë pyetje dhe disa nga problemet janë tejkualuar dhe zgjidhur me praktikën e përditshme gjyqësore.

Përderisa disa krahasime me legjislacione të ndryshme Evropiane dhe të Shteteve të Bashkuara ishin bërë ng Dr. Horst Proetel, trajnues gjyqësor në IGJK dhe Annette Williams, këshilltare ligjore në zyrën e SHBA-ve, procedura sipas rregullores ishte sqaruar nga z. Anton Nokaj, kryetar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, ndërsa qështja e veprave penale të dhunës në familje u sqarua nga Ruzhdi Berisha avokat nga Prizereni.

Pas prezantimeve shumë kohë iu kushtua diskutimeve. Ky rast u mirëprit dhe u shfrytëzua nga të gjithë pjesëmarrësit të cilët diskutuan me kolegët e tyre rreth problemeve që ata

kishin hasur gjatë praktikës së tyre gjyqësore. Gjatë diskutimeve u ngritën çështjet në vijim:

I. Neni 5.3 – kompetencat e gjykatës së qarkut për të shqyrtuar kërkesën për urdhërmbrojtje

Nëse një rast për shkurorzim është në shqyrtim pranë gjykatës së qarkut (sipas Ligjit mbi Martesën dhe Marrëdhanjet Familjare) – a është kjo gjykatë kompetente të vendosë përkitazi me lëshimin e urdherit për mbrojtje sipas nenit 5.3?

Pasi që neni 5.1 shumë qartë thotë që në përgjithësi gjykata komunale është kompetente rreth kësajë qështjeje, disa nga pjesëmarrësit ishin të mendimit se neni 5.3 në asnjë mënyrë nuk e cekë që kompetenca për këtë i takon gjykatës së qarkut. Është diskutuar gjithashtu që si pasojë një kompetencë e tillë rreth kërkesës për urdhërmbrojtje do të mund të bëhej edhe kompetencë e Gjykatës Supreme gjë e cila nuk ka qenë qëllim i ligjvënësit.

Pastaj neni 5.5 ka shkaktuar huti rreth kësajë qështje gjithashtu. Shumë pjesmarrës, nga kjo dispozitë kanë ardhur në përfundim që gjykata që lëshon urdhërin për mbrojtje është gjithashtu kompetente për të gjykuar rastet e shkeljes së këtyre urdhërave sipas nenit 45 (shih gjithashtu II). Nëse është kështu atëherë është e mundshme që gjykata e qarkut të jetë kompetente edhe pse sipas ligjit mbi gjykatat e rregullta një krim i tillë nuk duhet të gjykohet nga gjykata komunale.

Sidoqoftë pjesmarrësit tjerë theksuan se kompetente për këto raste duhet të jetë gjykata e qarkut Neni 5.3 definon qartë se gjykata është kompetente por nuk e cekë cila gjykatë.

Si parim i përgjithshëm termi “është” do të thotë “duhet të” dhe jo vetëm në kontekstin ligjor. Përrjashtimi mund të bëhet vetëm në rrethana të jashtzakonshme.

Prandaj kompetenca nuk iu është lënë në diskresion as të gjyqtarit as të parashtruesit të kërkesës.

Fakti se kjo mund të jetë kompetenë e mundshme e gjykatës së qarkut gjithashtu është mbështetur nga trainuesi gjyqësor Horst Proetel i cili theksoi se ky përjashtim arsyetohet pasi që e thjeshton procedurën shumë: në vend të dy gjykatave, kompetente do të jetë vetëm njëra gjykatë. Ai në mënyrë konstruktive u referua në dispozitat: 5.1 dhe 5.2 rreth rregullave të përgjithshme të cilat thonë që gjykata komunale është kompetente, neni 5.3 nuk tregon qartë në asnjë dispozitë se cila gjykatë është kompetente mirëpo referohet në LMMF. Përfundimisht neni 5.5 nuk është një

kundër-argument pasi që duhet të lexohet ndryshe shih II)

II. Përmbajtja e nenit 5.5 – a tejkalon kjo dispozitë ligjin për gjykatat e rregullta?

Shumë pjesmarrës kishin kuptuar nenin 5.5 si një dispozitë e cila rregullon kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës penale dhe në këtë mënyrë kjo ishte kuptuar si një dispozitë e përgjithshme që zëvendëson ligjin mbi gjykatat e rregullta rreth qështjeve penale. Ky interpretim i kombinuar me nenin 5.3 siç e kemi parë do të çojë deri te një përzierje totale të kompetencave të gjykatave, dhe nuk mund të thuhet se ligjvënësi ka pasur një qëllim të tillë.

Edhe nje kuptim tjetër i nenit 5.5 u prezantua nga trainuesi gjyqësor Horst Proetel. Ky interpretim u mbështet fuqimisht me krahasimin e ligjeve me shumë shtete Evropiane të cilat kanë dispozita të ngjashme. Këtu vendimtar është formulimi i dispozitave të nenit 5.5 i cili thotë se gjykata që lëshon urdhërin duhet të jetë kompetente edhe për të përcaktuar ndonjë shkelje të një urdhëri të tillë sipas nenit 15, është një ndryshim i qartë në këtë dispozitë e cila flet se a do të vendosë gjykata apo vetëm do të përcaktojë se a ka pasur shkelje të një urdhëri të tillë apo jo. Dispozita nuk parasheh ndonjë kompetencë tjetër për procedurën penale, vetëm përcakton se është në duart e të njejtit gjyqtar civil që të vendosë se a ka pasur shkelje të urdhërit apo jo. Një vendim i tillë ka një efekt kushtetues dhe është një parakusht për fillimin e çdo procedure penale.

Kështu kompetencat sipas ligjit mbi gjykatat e rregullta mbeten të pandryshueshme. Ky mendim edhe një herë mbështetet nga sistematika e kësajë Rregulloreje. Kapitulli I deri në III merren vetëm me qështjet civile ndërsa kapitulli IV (veprat dhe procedurat penale) merret me qështjet penale.

III. Terminologjia juridike e përdorur në Rregullore

Sikurse edhe në seminarin e nëntorit është adresuar edhe mosmarrëveshja rreth terminologjisë, përveq faktit ende ka një huti, kuptimit i termeve juridike deri më tani është mjaftë i qartë për të gjithë. Përderisa termi “parashtruesi i ankesës” është pranuar përgjithësisht përkthimi në gjuhën shqipe për fjalën “pala përgjegjëse” ende po shkakton disa kritika. Në mënyrë që të bëhet dallimi në mes lëmisë penale dhe asajë civile shumë folës kanë shprehur simpatinë për termin “palë përgjegjëse”. Sidoqoftë termet janë harmonizuar dhe është bërë me dije nga të gjithë se këto terme aplikohen dhe përdoren vetëm për procedurën civile.

IV. Lëshimi i urdhërit për mbrojtje nuk është dënim për palën përgjegjëse mirëpo qëllimi i vetëm i tij është që të mbron viktimat e dhunës familjare

A shkel shqiptimi apo (apo shtyerja) e masës mbrojtëse kundër një personi, parimin e dënimit të dyfishtë, për një vepër për të cilën kryesi tashmë ka vuajtur dënimin me burgim?

Neni 10.2 shumë qartë cekë se këto dy procedura nuk janë fare të ndërlidhura njera me tjetrën. Përveq kësajë urdhëri për mbrojtje fare nuk përbënë dënim në

asnjë moment, mirëpo vetëm mbrojtje për viktimën. Prandaj dënimi sipas ligjit penal dhe urdhëri mbrojtës i lëshuar në të njëjtën kohë për të njëjtën vepër nuk shkelin parimin e dënimit të dyfishtë. Ky problem tregon edhe një herë rëndësinë dhe nevojën për një dallim të qartë në mes të ligjit civil dhe atij penal.

V. A mundet pala e mbrojtur, e cila ka parashtruar kërkesë për urdhërmbrojtje emergjente të tërheq kërkesën? Kush është palë në procedurë?

Sipas nenit 6 kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente mund ta paraqes edhe pala e tretë, për shembull një person me të cilin pala e mbrojtur ka marrëdhanye familjare apo përfaqësuesi nga qendra për mirëqenje sociale. Nëse kështu është rasti, a mundet pala e mbrojtur të tërheqë kërkesën?

Gjithashtu duhet të pranohet se kjo dispozitë prekë të drejtën për jetë private e cila është e mbrojtur nga korniza kushtetuese dhe e drejta ndërkombëtare. Nëse këtu përfshihet pala e tretë atëherë duhet të gjindet një barazpeshë e përshtatshme në mes të dëshirës për të mbrojtur viktimën e dhunës familjare dhe respektimit të së drejtës kushtetuese të çdo personi për një jetë private dhe familjare. Pyetja duhet të përgjigjet duke u bazuar në historiatin e kryesit.

Në këtë rast pala e mbrojtur nuk është parashtruesi i kërkesës apo pala në procedurën ligjore kështu që ai/ajo nuk mund të tërheq kërkesën. Sidoqoftë sipas nenit 9.2 gjatë shqyrtimit të kërkesës gjykata do ta ndëgjoi palën e mbrojtur. Nëse bashkëshort/i/ja gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se nuk ka pasur dhunë familjare, atëherë gjyqtari

me siguri do ta pushon procedurën përveq nëse ai mbetet me përshtypjen se deklarata është e nxitur apo e detyruar.

Në fund të fundit gjykata nuk mund të veproj në kundërshtim me dëshirën e qartë të personit të mbrojtur. Qëllimi kryesor i Rregullores është që të mbështesë dhe të mbrojë viktimat e dhunës familjare, e jo të detyroj njerëzit në një ndihmë të tillë.

VI Skadimi i urdherit për mbrojtje emergjente

Siç është cekur në nenin 13.3 (b) një urdher i përkohshëm emergjent i lëshuar nga një agjencion policor nuk do të skadoj në ditën kur gjykata fillon punën mirëpo në fund të ditës së ardhshme në të cilën gjykata punon. Kjo garanton një mbrojtje të vazhdueshme pasi që gjykata brenda 24 orëve do të vendos përkitazi me urdhërin emergjent për mbrojtje sipas nenit 9.1.

Seminari është shfrytëzuar për të adresuar probleme praktike rreth rregullores.

Përderisa largimi i kryesit nga shtëpia është një zgjidhje e mirë në shtetet perendimore, në Kosovë kjo mund të

shkaktojë probleme pasi që gruaja (që të shumtën e rasteve është viktimë) jeton me familjen e burrit të saj të cilët nuk do të jenë të paanshëm ndaj viktimës. Është shumë e mundshme që familja së paku të ndikoj në të dhe shpesh herë viktimat edhe është objekt i diskriminimit. Përveq kësaj me sa duket situata aktuale në Kosovë shpesh nuk lejon hapsirë të mjaftueshme për intervenim gjyqësor pasi që sistemi i mirëqenjes sociale nuk mund të mbështes familjen në mënyrë adekuate nëse mbajtësi i vetëm i saj largohet apo burgoset. Nëse në këto rrethana parashtruesi i kërkesës tërheq kërkesën, pasoja ligjore do të jetë se rasti duhet të mbyllet. Sidoqoftë në rastet e tilla pyetja rreth nevojës së mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës mbetet e hapur.

IGJK është në dijeni rreth vështirësive që kanë mbetur mirëpo në të njëjtën kohë është e kënaqur kur kupton se shumë probleme janë zgjedhur gjatë punës praktike në gjykatat e Kosovës. IGJK do të mbajë edhe ndonjë seminar rreth kësajë qështjeje në ndonjë kohë tjetër.

Michael Frahm, IGJK

Programi i Aktiviteteve për muajin Korrik, 2004

- Seminar mbi Lgjin nga e Drejta Civile – eksproprijimi dhe kompensimi
- Seminar mbi Kodin e Përkohshëm Penal dhe Kodin Penal për të Mitur të Kosovës

Seminar mbi Lgjin nga e Drejta Civile – eksproprijimi dhe kompensimi

IGJK-ja do të organizoj në Seminar mbi eksproprijim dhe kompensim i cili do të mbahet me datën 7, korrik 2004. Temat të cilat do të prezantohen gjatë këtij seksioni trajnues kryesisht do të fokusohen në procedurën e eksproprijimit dhe kompensimit, anulimi i vendimeve të formes së prerë mbi eksproprijim, faza e shpronësimit sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe kryerja e veprave në lidhje me eksproprijim. Ekspertet të cilët do të kontribuojn këtij seminari do të jenë një Profesor mbi të Drejtën Procedureale Civile nga Fakulteti Juridik Prishtinë/Priština, një gjyqtarë nga Gjykata Supreme e Kosovës, një konsulent Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe një Trajnues Gjyqësor nga IGJK-ja. Ky seksion trajnimi ju adresohet gjyqtarëve të cilët punojnë në lami civile nga Gjykata Supreme, Qarkut dhe Komunale.

Seminar mbi Kodin e Përkohshëm Penal dhe Kodin Penal për të Mitur të Kosovës

IGJK-ja në bashkëpunim me Shërbimin Sprovues do të organizojn një seminar mbi Kodin e Përkohshëm Penal dhe Kodin Penal për të Mitur i cili do të mbahet me datën 15, korrik 2004, kështu qe ky seksion trajnimi i përbeshkët ka të bëjë me aspektet e veçanta ligjore sipas Kodit të Përkohshëm Penal dhe Kodit Penal për të Mitur. Tema e parë e cila do të prezantohet dhe diskutohet gjatë këtij seminari kryesisht fokusohet në lloje të ndryshme të dënimeve me kusht të cilat mund të shqiptohen sipas Kodit të Përkohshëm Penal dhe Kodit Penal për të Mitur (disa forma dhe modele të vendimeve gjyqësore në këtë procedurë gjithashtu do të prezantohen dhe diskutohen). Si pjesë e diskutimeve dhe prezantimeve të mëtutjeshme do të jenë Revokimi i dënimeve me kusht sipas Kodit të Përkohshëm Penal. Prandaj në vazhdim të këtij seksioni temat të cilat do të prezantohen kanë të bëjnë me rolin dhe përgjegjësit e zyrtarëve sprovues dhe punëtorve social sipas Kodit Penal për të Mitur, bashkëpunimi me gjyqtarët, si dhe detyrat për ndihmë dhe mbikqyrje të ndërmarrura nga Shërbimi Sprovues. Ekspertet të cilët do të kontribuojn këtij seminari janë një ekspert nga lamia penale (ish trajnues gjyqësor në IGJK), një gjyqtarë nga Gjykata Supreme e Kosovës, një gjyqtarë nga Gjykata e Qarkut Mitrovicë/Mitrovica, dhe drejtori nga Shërbimi Sprovues i Kosovës. Ky seksion trajnimi ju adresohet gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët punojnë në lami penale dhe zyrtarëve sprovues.

Nevojiten ekspert lokal për identifikimin e nevojave trajnuese dhe për përpilimin e plan-programit të ardhshë

Buletini i fundit ka treguar presencën e projektit të financuar nga AER-I “Ndërtimi Institucional i IGJK-së”. Këshilli Drejtues i Projektit së fundi e ka zgjatur projektin prej njëmbëdhjetë në pesëmbëdhjetë muaj dhe ka dhënë një sërë rekomandimesh të elaboruara nga grupi i projektit. (Më tepër për këtë në buletinim e ardhshëm).

Grupi i projektit tani është në mënyrë urgjente duke kërkuar gjykatës, prokurorë dhe avokat lokal të cilët dëshirojnë të punojnë me Dr Rainer Deville, Ekspertin e Trajnimeve Juridike, në arritjen e nevojave trajnuese të gjykatësve, prokurorëve dhe gjykatësve porotë që janë emëruar ose do të emërohen në të ardhën sikurse edhe në përpilimin e plan-programeve të ndryshme. Njohja e gjuhës angleze dhe gjermane do të jetë një vlerë shtesë mirëpo nuk është e domosdoshme pasi që projekti mund të ofroj përkthim.

Ajo çfarë i nevojitet projektit në vecanti është reagimi i detajuar nga ana e profesionistëve juridik në cafrëdo mungese e cila do të mund të ishte eksperiencuar në trajnimet e mbajtura për gjykatësit dhe prokurorët e tanishëm. Në gjithashtu do të kishim cmuar çfarëdo sugjerimi për trajnime të detajuara (teorike dhe praktike) të cilat duhet ofruar për gjykatësit dhe prokurorët e ardhshëm sikurse dhe gjykatësit porotë të tanishëm dhe atyre të ardhshëm.

Për informata të tjera, ju lutemi kontaktoni sa më shpejt zyrën e projektit.

Nëse nuk dëshironi ti bashkoheni grupit, ju lutemi që të adresoni çfarëdo sugjerimi të shkruar në zyrën e projektit përmes e-mail-it ose telefaksit:

Teleponi/Telefaksi: ++ 381 (0)38 246 005

Telefoni mobil: ++ 377 (0)44 403 179

Telefoni mobil i udhëheqësit të grupit: ++ 377 (0)44 398 587

E-mail-i i Udhëheqësit të Grupit: berg@ipko.net

E-mail-i i asistentes së projektit, Znjsh. Valëza Oruçi:

kjiproject@ipko.net